



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 10.2.2023

Nr: 52

Ora: 11:00

**VENDIM**

**PËR**

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË RAPORTIMEVE TË VEPRIMTARIVE TË BASHKISË DURRËS, PËR  
PERIUDHËN 24 JANAR – 2 SHKURT 2023**

Sot, më datë 10.2.2023, unë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, mora në shqyrtim çështjen administrative me,

**SUBJEKT:** Bashkia Durrës

**OBJEKTI:** Shqyrtim administrativ i raportimeve të veprimtarive të Bashkisë Durrës për periudhën 24 janar deri më 2 shkurt 2023.

**BAZA LIGJORE:** Neni 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, neni 21, pika 1, shkronja “dh” dhe neni 171, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”,

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

**KONSTATOJ:**

Gjatë periudhës së monitorimit 24 janar deri më 2 shkurt 2023, Bashkia Durrës ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve të KQZ-së, 19 (nëntëmbëdhjetë) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet “Inspektim/Kontroll”, raportuar në datë 24.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 25.1.2023,

Data: 10.2.2023 Nr: 52  
Ora: 11:00



“Për shqyrtimin administrativ të raportimeve të veprimtarive të Bashkisë Durrës, për periudhën 24 janar – 2 shkurt 2023”

- Aktivitet “Inspektim/Kontroll”, raportuar në datë 25.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 26.1.2023,
- Aktivitet “Inspektim/Kontroll”, raportuar në datë 25.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 26.1.2023,
- Aktivitet “Inspektim/Kontroll”, raportuar në datë 25.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 26.1.2023,
- Aktivitet “Inspektim/Kontroll”, raportuar në datë 25.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 27.1.2023,
- Aktivitet “Mbrëmje me interpretimin e aktorëve të skenës shqiptare, Kadare në Vargje”, raportuar në datë 25.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 28.1.2023,
- Aktivitet “Bisedim”, raportuar në datë 26.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 27.1.2023,
- Aktivitet “Inspektim/Kontroll”, raportuar në datë 26.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 27.1.2023,
- Aktivitet “Inspektim/Kontroll”, raportuar në datë 26.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 26.1.2023,
- Aktivitet “Inspektim/Kontroll”, raportuar në datë 28.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 31.1.2023,
- Aktivitet “Ceremoni”, raportuar në datë 28.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 28.1.2023,
- Aktivitet “Nënshkrim marrëveshje”, raportuar në datë 28.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 30.1.2023,
- Aktivitet “Seminar”, raportuar në datë 30.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 3.2.2023,
- Aktivitet “Inspektim/Kontroll”, raportuar në datë 30.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 3.2.2023,
- Aktivitet “Inspektim/Kontroll”, raportuar në datë 31.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 2.2.2023,
- Aktivitet “Takim”, raportuar në datë 31.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 2.2.2023,
- Aktivitet “Takim”, raportuar në datë 31.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 3.2.2023,
- Aktivitet “Mbledhje”, raportuar në datë 31.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 3.2.2023,
- Aktivitet “Inspektim dhe aktivitet ndergjegjësues”, raportuar në datë 2.2.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 3.2.2023.

Në datë 4.2.2023 administrata e KQZ i ka kërkuar Bashkisë Durrës nëpërmjet email-it, informacion sqarues në lidhje me shkaqet dhe rrethanat e kryerjes së shkeljes ose t’i paraqesë ato në seancën publike të datës 8.2.2023, ora 11:00.

Pas njoftimit të kryer nga KQZ, Bashkia Durrës nëpërmjet email-it ka paraqitur pretendimet e tij dhe ka sqaruar për secilin prej aktiviteteve se,

- *“aktiviteti ka qenë një detyrë rutinë dhe funksionale e kryetarit që nuk ka patur prezencë të mediave dhe as publikut, si dhe as premtime elektorale.*
- *pesë prej aktiviteteve nuk janë me nuancë politike por thjesht një inspektim rutinë e titullarit, i cili nuk është pasqyruar në radio, television, shtyp, faqe të internetit apo rrjete sociale që mundësojnë publikun e gjerë të njihet.*
- *katër prej aktiviteteve nuk janë zhvilluar si inspektim dhe as publikuar për shkak të ndryshimit të programit të punës të kryetarit.*
- *shtatë prej aktiviteteve nuk janë organizuar nga Bashkia Durrës, por ka qenë e ftuar.*
- *një rast nuk përbën aktivitet sepse është mbledhje jashtë rradhe e Këshillit Bashkiak, për shkak të procesit të rindërtimit.*
- *një rast është kërkuar të zhvillohej nga ana e shtetases italiane për marrjen e shtetësisë së saj, e cila për arsye personale duhej të largohej nga Shqipëria brenda datës 28.01.2023.”*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura, krijoi bindjen se gjashtë prej aktiviteteve janë raportuar jashtë afatit ligjor pa asnjë shkak të justifikuar. Nisur nga tematika e veprimtarive të raportuara, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se këto veprimtari përbëjnë veprimtari publike dhe Bashkia Durrës ka shkelur detyrimin ligjor duke mosraportuar brenda afatit të përcaktuar.

Për katër prej aktiviteteve, referuar pretendimit të Bashkisë Durrës se ato nuk janë zhvilluar, vlerësojmë se në këtë rast nuk jemi përpara kundërvajtjes administrative, për sa kohë sa veprimtaria nuk është zhvilluar.

Për shtatë prej aktiviteteve Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se Bashkia Durrës nuk ka patur detyrimin ligjor të raportojë për këtë aktivitet, për shkak se është në cilësinë e të ftuarit. Sipas nenit 92 pika 1 të Kodit Zgjedhor, kanë detyrimin për të raportuar në KQZ, të gjitha institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, që planifikojnë të zhvillojnë veprimtari me karakter publik, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

Për dy prej aktiviteteve, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, vlerëson se nuk përbëjnë veprimtari publike dhe Bashkia Durrës nuk ka patur detyrimin për raportimin e tyre.

Nga vendimmarrja e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve rezulton se, Bashkia Durrës është përsëritëse në shkeljen e detyrimit ligjor të raportimit brenda afatit të përcaktuar të veprimtarive publike.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, nenin 21, pika 1 shkronja “dh”, dhe nenin 171, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ligjin nr. 10279, datë 20.05.2012 “Për kundërvajtjet administrative”, vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”,

#### **V E N D O S:**

1. T’i propozojë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për zj. Dhurata Gjoka, Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Durrës, me gjobë në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**